



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.Shk.II.nr.213/2024

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË- Dhomat e shkallës së dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Bajrami kryetar i kolegjit, Saranda Bogaj-Sheremeti dhe Franciska Zhitija -Ymeri anëtar të kolegjit, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit paditësit Engineering I.B sh.a me seli Istog, e përfaqësuar nga D.Gj., e te cilin sipas autorizimit F.Sh. avokat nga Prishtina, kundër të paditurit “Cerrca Teknik” sh.a, me seli në Kovragë, Komuna e Istogut, e të cilin sipas autorizimit e përfaqëson L.T., avokat nga Peja, për shkak të pengim posedimit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të parashtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, KP.nr.45/23, të datës 11.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt. 19.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET SI E PATHEMELTË ankesa e paditësit Engineering I.B sh.a me seli Istog, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, KP.nr.45/23, datë 11.12.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin, KP.nr.45/23, të datës 11.12.2023, ka vendosur si vijon :

“...HUDHET poshtë padia e paditësit Engineering I.B sh.a me seli Istog, me NUI 811224584, kundër të paditurës “Cerrca Teknik” sh.a, me seli në Kovragë, Komuna e Istogut me NUI 811224617, si e palejuar”.

Kundër aktvendimit KP.nr.45/23, të datës 11.12.2023 të marrë nga Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, në afat ligjor paditësi ka paraqitë ankesë, me të cilën ankesë ndër të tjera ka kërkuar që Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë ta kthej lëndën në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë, në seancën e kolegjit, në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, e ekzaminojë aktvendimin e shkallës së parë brenda kufijve dhe shkaqeve të treguara në ankesë si dhe duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore dhe gjeti se:

-Ankesa është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Padiësi "Engineering I.B" Sh.A përmes te autorizuarit Avokat F.Sh. me datën 06.09.2023 pranë kësaj gjykate ka ushtruar padi kunder te paditurit "Cerrca Teknik" Sh.A, me te cilën ka kërkuar qe te aprovohet kërkesë padia dhe te vërtetohet se i padituri me datën 23.08 dhe 24.08.2023 e ka penguar padiësin ne shfrytëzimin e zyrës e cila ishte në posedim nga padiësi dhe ne te cilën gjinden mjete dhe pajisje personale te padiësi dhe e njëjta ka pasur qasje ne zyre pa dijeninë e padiësit ne ngastrën kadastrale 93-3, dhe ka angazhuar punëtor për spërkatje me herbicide totale ne parcelën 94-0 ne gjatësi prej 81.50m.

E paditura nëpërmjet te autorizuarit Avokat L.T., me date 18.10.2023 ka parashtruar përgjigjen ne padi, duke e kontestuar ne tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e padiësit, pos tjerash ka theksuar se padia është e mangët, referati i padisë është i pa qarte si dhe vete kërkesa padia është jo e plote, duke theksuar se i padituri është pronar legjitim i palujtshmerise me numër 93-3 e ne te cilen ka te ndertuar objektin per përpunimin e metaleve e te cilin e shfrytëzon edhe aktualisht, sa I perkete pretendimeve te pales paditese i ka cilesuar si te pabazuara duke sqaruar se qe nga muaji Maj 2023 ketu paditesit I eshte nderprere kontrata dhe I njëjti nuk ka pasur qasje ne këtë objekt, duke i propozuar gjykatës që pas administrimit të provave, të marrë aktvendim për refuzimin e padisë dhe kërkesëpadisë së padiësit si të pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin KP.nr.45/23, të datës 11.12.2023 e ka hudhë si të pas afatshme padinë e padiësit, dhe në arsyetimin e aktvendimit të atakuar, e ka arsyetuar se nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, si procesverbali i seancës se datës 06.12.2023 përkatësisht nga vet deklaratimet e padiësit te dhëna gjate seancës se vend shikimit, konstatoi se atij, pra padiësit i është pamundësuar te hyje ne objekt qe nga data 03.06.2023 nga e paditura dhe punëtoret e saj, ndërsa padinë në gjykatë e ka ushtruar me datë 06.09.2023, kështu që padiësi padinë e ka parashtruar jashtë çdo afati ligjor.

Gjykata e shkallës se dyte e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë në këtë procedurë kontestimore drejt e ka vërtetuar gjendjen faktike kur konstaton se me date 03.06.2023 padiësi ishte ne dijeni se është privuar nga posedimi, qe nga koha kur i punësuari i te paditurës e ka penguar padiësin ne shfrytëzimin e zyrës se tije. Andaj, meqenese

ne rastin konkrete kontesti është zhvilluar mbi bazën e pengim posedimit, e për të cilin lloj të kontesteve janë përcaktuar afate prekluzive për paraqitjen e padisë, ndërsa paditësi në gjykatë padinë e ka dorëzuar me datë 06.09.2023, në ditën e 96 nga dita në të cilin pretendon se i është privuar posedimi i tij.

Sipas nenit 114 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore (Ligji nr.03/L-154), në të cilin përcaktohet se "Kërkesa mund të parashtrohet vetëm në afatin prej 30 (tridhjetë) ditësh, pasi që se poseduesi e merr dijeni lidhur me privimin apo pengimin e posedimit të tij. Kërkesa shuhet pas kalimit të një viti nga privimi ose pengimi i posedimit"

Bazuar në deklarinimin e përfaqësuesit të paditësit dhe dispozitës ligjore të sipër cekur gjykata konstaton se afati 30 ditor, për paraqitjen e padisë ishte data 03.07.2023, për faktin se paditësi sipas deklarinimit të tij i është pamundësuar qasja në zyrën e tij nga data 03.06.2023.

Gjykata i shqyrtoi të gjitha pretendimet ankimore themelta dhe konstatoj se janë të pathemelta, pra të pa bazuara. Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së dytë
Kom.Dh.Shk.II.nr.213/2024 dt.19.04.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,
Faton Bajrami